



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 4

Tiranë – E hënë, 8 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 1789, datë 2.6.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2153, datë 7.7.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2162, datë 7.7.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2166, datë 7.7.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2179, datë 7.7.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 2193, datë 7.7.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 4749, datë 21.12.2015	Vendim Komisionit të Ankimit..... 4
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 664, datë 2.2.2016	Shprehje interesi, shërbime konsulence, “Për fushatë komunikimi për reformën spitalore” 5
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 1552, datë 2.2.2016	Njoftim për shitje..... 8

Njoftim i Ministrisë së Financave
nr. 822, datë 20.1.2016

Për shitjen 100% të paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti
në shoqërinë “INSIG” sh.a.....

10



VENDIM
Nr. 1789, datë 2.6.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 12, datë 2.10.2014, të subjektit “Odetta Toto”, protokolluar me nr. 1416, datë 10.10.2014;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm, nr. 12, datë 2.10.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 500.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM
Nr. 2153, datë 7.7.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 7, datë 21.2.2015, të subjektit “Arlind Mustafaj”, protokolluar me nr. 639 datë, 27.2.2015;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 7, datë 21.2.2015, i dënimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM
Nr. 2162, datë 7.7.2015

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar nr. 13, datë 6.11.2014, të subjektit “Ferrari”, me nr. 1788 protokoll, datë 14.11.2014;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm, nr. 13, datë 6.11.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 50.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

**VENDIM****Nr. 2166, datë 7.7.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 13, datë 29.10.2014, të subjektit “Manjola Ismail”, me nr. 1823 protokoll, datë 17.11.2014;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 13, datë 29.10.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 300.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM**Nr. 2179, datë 7.7.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 756, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 13, datë 8.11.2014, të subjektit “C1”, me nr. 1874 protokoll, datë 20.11.2014;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146 pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Faqe | 4

Vendimi i mësipërm, nr. 13, datë 8.11.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 50.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

VENDIM**NR. 2193, datë 7.7.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 4, datë 5.11.2014, të subjektit “Harem Tirana”, protokolluar me nr. 1815, datë 17.11.2014;

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se materiali ankimor i paraqitur nuk është i plotë dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Për vendimin e mësipërm nr. 4, datë 5.11.2014, i dënimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë, subjektit i lind e drejta mbas njoftimit të ankimohet.

Për sa më lart, Komisioni i Ankimit

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

KRYEINSPEKTOR
ERGYS AGASI

VENDIM**Nr. 4749, datë 21.12.2015****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr. 5, datë 25.5.2015, të ISHMP, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Iljado Osmenaj” sh.p.k., protokolluar me nr. 1725, datë 28.5.2015;



Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika “a”, të ligjit nr. 485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimi i mësipërm nr. 5, datë 25.5.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Iljado Osmenaj”, i dënimit me gjobë në vlerën 50.000 lekë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm.

Për sa më lart, komisioni i ankimit

VENDOSI:

Rrëzimin e ankimit të subjektit/personit/bashkimi i shoqërive “Iljado Osmenaj” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të vendimit përfundimtar nr. 5, datë 25.5.2015, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

**KËRKESË E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË
Nr. 664, datë 2.2.2016**

**PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIME KONSULENCE**

3 shkurt 2016

PËR FUSHATË KOMUNIKIMI PËR
REFORMËN SPITALORE

Shqipëri

Projekti i përmirësimit të sektorit të shëndetësisë

Kredi nr: 8466 AL

Numri i identifikimit të projektit: P144688

Referenca e shërbimit: HSIP/CS/CQ/03-2015

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së *Projektit të përmirësimit të sektorit të shëndetësisë* (HSIP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbime konsulence.

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë (MSH) ka për synim përmirësimin e

shërbimeve të saj laboratorike nëpërmjet pjesëmarrjes së sektorit privat. Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë shërbimet laboratorike publike në Shqipëri, nëpërmjet tërheqjes së një partneri publik privat (PPP), për të investuar në strukturën dhe për të operuar një rrjet të laboratorëve publikë.

Shërbimi i konsulencës (Shërbimet) së kërkuar është **“Fushatë të komunikimit për reformën e spitaleve”**. Nëpërmjet këtij shërbimi, MSH-ja kërkon pajtimin e një firmë lokale komunikimi/PR, që do të ndihmojë e do të mbështesë MSH-në në marrëdhëniet e saj me publikun dhe ekipin menaxhues që punon për partneritetin publik privat në lidhje me laboratorët (PPP). Kjo do të përfshijë, një sërë editorialesh, pikat e bisedës (TPS), FAQ-së, detyrat analitike, sikurse dhe mbështetje për nismat më të gjera të komunikimit të MSH-së.

Firma konsulente e suksesshme, duhet të demonstrojë një përvojë të paktën prej 10 vjetësh në fushën e komunikimit/PR. Konsulenti do të jetë një kompani lokale dhe/ose agjenci ose grupe agjencish komunikimi e marketingu, të cilat ofrojnë prodhime reklamash, marrëdhënie me publikun ose subjekte të tjera të specializuara...

Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Njësisë së Koordinimit të Projektit (PCU), fton të gjithë kompanitë konsulente lokale, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimit me publikun (Konsulenti), ligjërisht të pranueshme, të shfaqin interesimin e tyre për shërbimin e kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet. Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.



Kriteret e Shortlistimit dhe të vlerësimit janë:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve), në fushën e detyrës	30 points
2.	Numri i shërbimeve të ngjashme/kontratave të kryera gjatë tri viteve të fundit	40 points
3.	Eksperiencat e ngjashme dhe kualifikimi i personelit kryesor	30 points
TOTAL		100 points

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesi i Konsulencës) - version i janarit të 2011-s, rishikuar në korrik 2014.*

Konsulenti do të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve (version i janarit të 2011-s, rishikuar në korrik 2014.

Shërbimi do të kryhet brenda një periudhe prej 5 muajsh. Konsulenti pritet të fillojë shërbimin në muajin mars 2016, dhe ta perfundojë atë në muajin korrik 2016.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **18 shkurt 2016**.

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
NJËSIA E KOORDINIMIT TË
PROJEKTIT (PCU)
PROJEKTI I PËRMIRËSIMIT TË
SEKTORIT TË SHËNDETËSISË**

Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të:
Znj. Milva Ekonomi
e-mail:

Milva.Ekonomi@shendetesia.gov.al

Znj. Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Znj. Elma Dogani

e-mail: hsip.dogani@gmail.com

**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF
INTEREST (REOI)
(CONSULTING SERVICES)**

February 3, 2016

**ALBANIA
ALBANIA HEALTH SYSTEM
IMPROVEMENT PROJECT (HSIP)**

LOAN NO: 8466 AL.

PROJECT ID NUMBER: P144688

Assignment Title: Communication campaign for hospitals' reform Local Consultant Company-Communications/PR firm

Reference No. **HSIP/CS/CQ/03-2015**

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Health System Improvement Project (HSIP), and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The Ministry of Health of the Republic of Albania (MoH) is aiming at improving its laboratory services through private sector participation. The objective of this project is to improve public laboratory services in Albania by attracting a PPP partner to invest structure and operate a network of public labs.

The consulting services (the Services) include “**Communication campaign for hospitals' reform**”. Through this service, the MoH is seeking a Communications/PR firm to help support the MoH's Public Relations and management team working for the Lab Public-Private-Partnership (PPP). This will involve, but not only, a range of editorial, Talking Points



(TPs), FAQs, and analytical tasks, as well as support on broader MoH communication initiatives.

The successful Consultant firm will have demonstrated experience of about **10 years** in the field of communication/PR. The Consultant will be a local company/Agency or marketing communications Group of Agencies which possesses well established advertising, public relations and organizational departments or separated specialized entities/companies

The short listing criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment	30 points
2.	Number of assignment-related contracts completed during last three years	40 points
3.	Assignment-relevant experience of key personnel	30 points
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The selection method to be applied is **Consultants Qualification Selection (CQ)**, in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants Under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers" (January 2011, revised July 2014).

The assignment should be performed within 5 months period. The consultant is expected to start the service on March 2016 and completed by July 2016

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30

The Ministry of Health, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible Local Consultant Company-Communications /PR firm (Consultants), to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

(Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **February 18, 2016**.

MINISTRY OF HEALTH (MOH)
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project (HSIP)

Tirana, Albania

Att: Milva Ekonomi

e-mail:

Milva.Ekonomi@shendetesia.gov.al

Att: Blerina Dudushi

e-mail: hsip.dudushi@gmail.com

Att: Elma Dogani

e-mail: hsip.dogani@gmail.com



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 1552, datë 2.2.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, pika 14, shpall për shitje si më poshtë:

Në pronësi të Bashkisë Peshkopi

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ambiente artizanale	Ish-PAM Dibër	886 599	640 935	245 664	72	72	01.03.2016	10.00	DDPP

Në pronësi të Bashkisë Elbasan

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Bodrum	Pallati nr. 57/1, lagjja “Luigj Gurakuqi”, Elbasan	808 898	759 990	48 908	31.02	31.02	01.03.2016	11.00	DDPP

Në administrim të Komunës Potom

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Shkolla e vjetër (ZK 3037 nr. pasurie 193/67)	Potom Skrapar	103 958	98 412	5 546	47	47	01.03.2016	12.00	DDPP
2	Ish-Shkolla e vjetër (ZK 3037 nr. pasurie 193/68)	Potom Skrapar	407 371	387 075	20 296	172	172	01.03.2016	12.30	DDPP



4. Në varësi administrative të Bashkisë Klos

Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
Ndërtesë e çerdhes së fëmijëve	Klos	6 804 398	6 519 985	284 413	152.91	152.91	01.03.2016	13.00	DDPP

Në administrim të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit

Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
		Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
NFK Ndërfushas	Rrëshen	11602 553.3	6 024 164.3	5 578 389	30 483	2 895.3	01.03.2016	14.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave;

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave;

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim**, për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave;

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave;

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës;

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla;

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare, duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

**NJOFTIM TENDERI PËR SHITJEN 100%
TË PAKETËS SË AKSIONEVE TË
ZOTËRUARA NGA SHTETI NË
SHOQËRINË “INSIG” SHA**

Referuar nenit 3, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar; nenit 1, të ligjit nr. 8831, datë 22.11.2001, “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 21.8.1998, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që zotërohen nga shteti”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.6.2015, “Për caktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a.” dhe urdhrin të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 8961/1, datë 22.12.2015, Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike shpall për shitje me tender paketën e aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a., me seli qendrore në Tiranë, si më poshtë:

**I. EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE
VENDNDODHJA E SAJ**

Emri i shoqërisë: Shoqëria “INSIG” sh.a., Tiranë, Albania, Kosovë dhe Maqedoni.

Adresa: Zyra qendrore e shoqërisë, Rruga e Kavajës, nr. 116, Tiranë

Tel: ++355 42 234170

**II. FORMA E TENDERIT DHE FORMULA
E PRIVATIZIMIT**

1. **Formula e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a. do të jetë shitja 100% e paketës shtetërore.** Vlera e 100% e aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a. është **15,305,000 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e pesë mijë) euro** e konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të datës së publikimit të “Ftesës për

ofertë”, datë 25.1.2016.

2. Forma e shitjes së shoqërisë “INSIG” sh.a., Tiranë, do të jetë tenderi i hapur, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 21.8.1998, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që zotërohen nga shteti”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.6.2015, “Për caktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a.”.

3. Procedurat e tenderit do të realizohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 21.8.1998, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që zotërohen nga shteti”, të ndryshuar.

**III. VENDI, AFATI DHE PAGESA PËR
TËRHEQJEN E DOKUMENTACIONIT TË
TENDERIT**

1. Tërheqja e dokumentacionit bëhet në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, çdo ditë, nga data 26.1.2016 deri në datën 9.3.2016, nga ora 10:00–15:00 në këtë adresë:

Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Spektori i dokumentacionit

Z. Ildir **XHOXHI**

Tel: ++ 355 42227933

2. Kandidatët e interesuar brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, kundrejt dokumentit origjinal që vërteton pagesën e shumës së përcaktuar 10 000 (dhjetë mijë) lekë, me përshkrimin “Për blerje dokumentacioni tenderi të shoqërisë “INSIG” sh.a.”, mund të tërheqin dokumentacionin e tenderit. PAGESA bëhet pranë bankave të nivelit të dytë pasi të jenë pajisur me formularin e pagesës. Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe të shpërndarjes së dokumenteve tek ofertuesit. Ofertuesit e interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë dokumentet para blerjes së tyre.



3. Kandidatët e interesuar mund të tërheqin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Listën e pasurive të paluajtshme të shoqërisë tregtare dhe informacionin për statusin juridik të tyre;

b) Afatet dhe kushtet e shitjes, duke përfshirë aplikimin e metodave të pagesës dhe një sistem të mundshëm të kërkesave lidhur me politikën e biznesit, politikën e punësimit dhe zhvillimit etj., garancitë e nevojshme dhe sanksionet në lidhje me detyrimet;

c) Vendi ku drejtohen pyetjet në lidhje me tenderin dhe mundësitë për sigurimin e informacionit shtesë;

d) Specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimi i afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës;

e) Bilancet për 3 vitet e fundit të aktivitetit të shoqërisë;

f) Vlerën e paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare që ofrohet në tender;

g) Materialin informativ përmbledhës me të dhënat kryesore të shoqërisë tregtare që privatizohet;

h) Të dhënat për shitjen:

- madhësia e paketës për shitje;
- vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë;

j) Procedurat e vlerësimit të dokumentacionit dhe kriteret përkatëse me konsiderata të veçanta për sa më poshtë:

- koha dhe vendi i hapjes së ofertave;
- përcaktimi i kohës për vlerësimin e ofertave;
- mënyra dhe vendi i shpalljes së rezultateve të tenderit;

k) Lista përmbledhëse e dokumentacionit të ftesës për tender dhe anekset.

4. Ruajtja e konfidencialitetit

a) Kandidati për tender do të trajtojë në mënyrë konfidenciale përmbajtjen e ofertave deri në përfundim të Kontratës së shitjes.

b) Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike ka të drejtë ta quajë ofertën e kandidatit përkatës të pavlefshme dhe ta anulojë atë, në qoftë se kandidati apo ndonjë person tjetër, përfaqësues i tij, dhunon konfidencialitetin lidhur me tenderin.

c) Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike do të ruajë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave të kandidatëve deri në përfundimin e tenderit dhe nuk do të japë

informacion lidhur me përmbajtjen e tyre.

d) Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, do t'i përdorë ofertat vetëm për vlerësim. Nëse ato do të duhet të përdoren për qëllim tjetër, të dyja palët duhet të bëjnë një marrëveshje të veçantë.

Informacioni shtesë do të jepet në këmbim të një deklarate me shkrim për ruajtjen e konfidencialitetit për dokumentacionet e tërhequra.

IV. ORGANIZIMI I TENDERIT, PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË TIJ DHE VLERËSIMIT TË OFERTAVE

A. Vendi, mënyra dhe data e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave

1. Kandidatët e interesuar **ditën e enjte, datë 10.3.2016, në orën 10:00**, do të paraqesin dorazi ofertat e tyre në Ministrinë e Financave, Tiranë, para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Oferta duhet të jetë në 5 (pesë) kopje, në zarf të mbyllur, e vulosur, pa emrin e kandidatit në pjesën e jashtme të zarfit. Nuk lejohet që në zarf të paraqitet me shumë se një ofertë. Çdo faqe e pesë kopjeve të ofertës duhet të ketë firmën origjinale të kandidatit (ose të të autorizuarit prej tij).

2. Dokumentacioni i paraqitur në ofertë duhet të jetë në gjuhën shqipe ndërsa për investitorët e huaj edhe në anglisht.

3. Çdo kandidat do të paraqesë vetëm një ofertë. Oferta e dhënë nga secili kandidat nuk do të pranohet në rastin kur ajo është e lidhur me oferta të dhëna nga kandidatët e tjerë pjesëmarrës në tender.

4. Oferta e paraqitur nga kandidati duhet të përmbajë:

a) Deklaratën me anë të së cilës kandidati angazhohet, për:

- pranimin e kushteve të përcaktuara në ftesën për tender;

- marrjen përsipër të detyrimeve dhe shërbimeve që rrjedhin nga pranimi;

- pagimin e çmimit të paraqitur në ofertë, sipas Kontratës me Ministrinë e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike;

b) Vendimin e regjistrimit në regjistrin ose aktin publik që vërteton regjistrimin e tyre si të tillë në vendin e origjinës;

c) Dokumentin bankar që vërteton ngrirjen, për periudhën deri në nënshkrimin e Kontratës



së shitjes të pagesës paraprake në lekë ose garanci bankare me vlerën 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë, që ofrohet për tender, në datën dhe mënyrën e specifikuar në ftesën për tender. Kjo shumë ngrihet për llogari të Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave.

d) **Dokumente referencash** nga institucione bankare dhe financiare, klient i të cilave është kandidati;

e) **Dokumente** lidhur me përvojën e tyre në treg, besueshmërinë apo profilin, elemente këto që kanë të bëjnë me vlerësimin e kredencialeve të ofertuesit kandidat për blerje;

f) **Çmimin e ofruar për blerje**. Çmimi i ofruar për blerje kërkohet të jetë vetëm në lekë;

g) **Planin e biznesit**. Në të duhet të pasqyrohen mendimet e kandidatit mbi veprimtarinë aktuale, si dhe ndryshimet e mundshme. Plani i biznesit duhet të reflektojë investimet që do të kryhen, si edhe çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme nga kandidati;

h) **Bilancet kontabël** të audituar të paktës për tri vitet e fundit;

i) Raportet e auditorëve për tri vitet e fundit;

j) Listën e përmbajtjes së dokumentacionit të ofertës me fletët përkatëse.

5. **Oferta** duhet të tregojë qartë dhe pa keqkuptime që kandidati pranon të mbajë ofertën e tij të vlefshme nga momenti i dorëzimit të saj para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas afatit të përcaktuar në këtë ftesë për tender deri në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

6. **Dorëzimi dhe hapja e ofertave** bëhet konform kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 21.8.1998, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që zotërohen nga shteti”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.6.2015, “Për caktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a.”. Kandidati dorëzon dorazi ofertën në zarf te punonjësi i arkiv protokollit sipas përcaktimit të bërë në këtë ftesë në prani të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

7. Shpenzimet për përgatitjen e ofertave dhe përfshirjen e kandidatit në tender, përballohen nga pjesëmarrësit në tender, pavarësisht nga

vlefshmëria e ofertave dhe suksesi ose dështimi i tenderit.

Kalendari i procedurave të tenderit do të jetë:

Hapat në procedurat e tenderit	Dita	Data
Fillimi i publikimit të ftesës për tender	0	25.1.2016
Përfundimi i periudhës së publikimit të ftesës për tender	30	23.2.2016
Dorëzimi i ofertave nga kandidatët para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	45	10.3.2016
Vlerësimi i ofertave	45–55	19.3.2016
Përgatitja e projektvendimit dhe relacionit mbi tenderin	56–62	25.3.2016
Pagesa e vlerës së plotë dhe lidhja e Kontratës së shitjes	30 ditë pas shpalljes së VKM-së për fituesin e tenderit.	

B. Kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim të ofertës

1. Autoriteti kualifikon në procedurat e tenderit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

a) Formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet e tenderit;

b) Vendimin e regjistrimit në regjistrin ose aktin publik që vërteton regjistrimin e tyre si të tillë në vendin e origjinës/ose ekstraktin e regjistrimit në regjistrin tregtar për subjektin;

c) Dokument referencash nga institucionet bankare dhe financiare.

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë lëshuar nga autoritetet përkatëse, jo më vonë se 3 muaj nga data e hapjes së ofertave.

d) Kandidati duhet të paraqesë vetëm një ofertë. Oferta duhet të përmbajë deklaratën me anë të të cilit kandidati angazhohet, për: pranimin e kushteve të përcaktuara në ftesën për tender, marrjen përsipër të detyrimeve dhe shërbimeve që rrjedhin nga pranimi dhe shumën për çmimin e ofruar dhe alternativat e tij.

Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër (nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim). Sipas rastit, institucioni përgjegjës mund të investigojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse në vendin e origjinës dhe në rast se konstaton zyrtarisht se në shtetin e origjinës ekziston një institucion, i cili mund të lëshojë dokumentacionin e mësipërm administrativo-ligjor, i cili është



paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetëdeklarimit, atëherë Komisioni do ta quajë të pavlefshëm dokumentin vetëdeklarues të paraqitur.

2. Autoriteti, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

C. Kriteret bazë të vlerësimit të ofertave do të jenë:

Nr.	Kriteri	Pikët
	Çmimi më i lartë i ofruar (merr maksimumin e pikëve)	80
	Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit	10
	Cilësia e investitorit (merr pikët maksimale kandidati i cili ka eksperiencë në tregun e sigurimeve dhe shtrirje rajonale/ ndërkombëtare)	10
	TOTALI	100

V. SPECIFIKIME PËR GARANCINË E TENDERIT DHE PËRCAKTIMI I AFATIT PËRFUNDIMTAR PËR VLEFESHMËRINË E OFERTËS

1. Kushti i garancisë së tenderit do të kthehet, në rast se:

- ftesa për tender është anuluar;
- dokumentet e paraqitura për oferte janë të pavlefshme;
- pjesëmarrësi nuk është fitues i tenderit;
- kontrata nuk është e përfunduar, për shkaqe

për të cilat Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave është përgjegjëse.

2. Kushti i garancisë së tenderit nuk do të kthehet në rast se:

- në pajtim me ftesën për tender ajo është transformuar në një siguri suplementare për garantimin e përfundimit të Kontratës;
- anulohet nga kandidatët oferta e paraqitur në tender gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave;
- kandidati është gjetur përgjegjës për moslidhjen e Kontratës;
- kontrata nuk është përfunduar për çdo arsye që bie ndesh me interesat e kandidatëve të tjerë pjesëmarrës në tender.

LISTA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTACIONIT TË OFERTËS

Nr.	Lloji i dokumentacionit të ofertës sipas kapitullit VII, pika 3 e ftesës për tender	Numri i fletëve
1	Deklarata e angazhimit etj. (germa "a")	Nga 1 deri ____
2	Vendimi i regjistrimit etj. (germa "b")	Nga 1 deri ____
3	Dokumenti bankar për etj. (germa "c")	Nga 1 deri ____
4	Dokumente referencash etj. (germa "d")	Nga 1 deri ____
5	Çmimi i ofruar i blerjes etj. (germa "f")	Nga 1 deri ____
6	Dokumentacioni për reputacionin e përvojën etj. (germa "e")	
7	Plani i biznesit etj. (germa "g")	Nga 1 deri ____
8	Bilancet kontabël të audituar etj. (germa "h")	Nga 1 deri ____
9	Raportet e auditorëve etj. (germa "i")	Nga 1 deri ____

SHTOJCA 1

FORMULARI I OFERTËS

[Data ____ . ____ . 2016]

Për: [Ministrinë e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike]

Procedura e tenderit: Shitja 100% e aksioneve të shoqërisë "INSIG" sh.a.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së tenderit : Tender i hapur

Publikimi i njoftimit në Buletinin e Njoftimit Publik, Qendra e Botimeve Zyrtare:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë dhe pranojmë, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në këto dokumente;
2. Ne i përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumente, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;
3. Ne shprehim interes për të marrë pjesë në procedurë, në rast përzgjedhjeje nga autoriteti si kandidatë fitues;



4. Çmimi total i ofertës sonë është _____ lekë [dhe vlera e ofertës];
 5. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentet e tenderit;
 6. Ne autorizojmë autoritetin shitës të verifikojë informacionin/dokumentet, që i bashkëlidhen kësaj oferte.
 7. Pajtohem për të firmosur Kontratën nëse shpallëm fitues.
 Përfaqësuesi i ofertuesit
 Nënshkrimi

 (Vula)

SHTOJCA 2

[Letër me logon e bankës]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____2016]

Për: [Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e konkurrimit: [Tender i hapur]

Përshkrimi i shkurtër i Kontratës: [Objekti]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra], si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga ofertuesi i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit prej kushteve të mëposhtme:

- në pajtim me ftesën për tender ajo është transformuar në një siguri suplementare për garantimin e përfundimit të Kontratës;
- anulohet nga kandidatët oferta e paraqitur në tender gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave;
- kandidati është gjetur përgjegjës për moslidhjen e Kontratës;
- kontrata nuk është përfunduar për çdo arsye që bie ndesh me interesat e kandidatëve të tjerë pjesëmarrës në tender.

Ky sigurim është i vlefshëm deri ditën e nënshkrimit të Kontratës së shitjes me fituesin e tenderit të shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave. Zhbllokimi i garancisë së tenderit do të bëhet me autorizim të lëshuar nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.

[Përfaqësuesi i bankës/]

SHTOJCA 3

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e tenderit:

Përshkrim i shkurtër i procedurës dhe i objektit të tij:



Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i ofertuesit

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i ofertuesit

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i ofertuesit

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është identifikuar si oferta e suksesshme.

SHTOJCA 4

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Nr.	Kriteret	Vlera maksimale e pikëve, për	Vlerësimi në pikë	Formula e llogaritjes në pikë për vlerat e ofertuesve
1	Çmimi më i lartë i ofruar	Vlerën maksimale të kriterit	80	$V_p = \frac{V_o}{V_{max}} \times 80$
2	Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit	Vlerën maksimale të kriterit	10	$P_p = \frac{P_o}{P_{max}} \times 10$
3	Cilësia e investitorit	Vlerën maksimale të kriterit	10	$C_p = \frac{C_o}{C_{max}} \times 10$
	TOTALI I PIKËVE		100	

Ku:

V_p – Pikët e llogaritura të ofertuesit (i)

V_{max} – Vlera maksimale e çmimit të ofruar

V_o – Vlera e ofertuesit (i)

P_p – Pikët e llogaritura të ofertuesit (i)

P_{max} – Vlera maksimale në lidhje me planbiznesin

P_o – Vlera e ofertuesit (i)

C_p – Pikat e llogaritura të ofertuesit (i)

C_{max} – Vlera maksimale në lidhje me cilësinë e investitorit

C_o – Vlera e ofertuesit (i)



DEKLARATË ANGAZHIMI E KANDIDATIT

Unë i (Ne të) nënshkruari/t _____ (kandidati, përfaqësuesi i shoqërisë) deklarojmë se jemi bërë të njohur me përmbajtjen e ftesës për tender të publikuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike për shitjen me tender të hapur të shoqërisë “INSIG” sh.a.

Në bazë të dokumentacionit të tërhequr nga ana jonë pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, vlerësimeve tona dhe informacionit për këtë shoqëri, kërkojmë të blejmë këtë shoqëri duke paraqitur ofertën tonë pjesë përbërëse e së cilës është edhe kjo deklaratë.

Deklarojmë se njohim dhe pranojmë kushtet e përcaktuara nga Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në ftesën për tender të shoqërisë “INSIG” sh.a. dhe se marrim përsipër detyrimet dhe shërbimet që rrjedhin nga pranimi ynë.

Deklarojmë se jemi njohur me kushtet e shoqërisë “INSIG” sh.a., kemi shqyrtuar dokumentacionin dhe pasqyrat e bilancit, kemi kryer ekzaminimin e nevojshëm dhe në ofertën tonë nuk mbështetemi vetëm në informacionin e marrë nga Shitësi për këtë shoqëri.

Deklarojmë se do të paguajmë çmimin prej _____ lekësh, të ofruar nga ana jonë në ofertën për blerjen e shoqërisë “INSIG” sh.a. brenda afatit të përcaktuar në ftesën për tender.

Jemi dakord që të gjitha angazhimet tona të shprehura në ofertën për tender që po paraqesim të jenë pjesë përbërëse e Kontratës së shitblerjes së shoqërinë “INSIG” sh.a.

Deklarojmë se do të ruajmë dhe do të zhvillojmë profilin e biznesit të shoqërisë “INSIG” sh.a. brenda fushës së veprimtarisë së përcaktuar në aktet e themelimit të saj sipas planbiznesit të paraqitur në ofertë nga ana jonë.

Deklarojmë se nuk do të lëshojmë asnjë informacion apo të dhënë të përfutur nga ne gjatë procesit të tenderit.

Deklarojmë se pranojmë të mbajmë të vlefshme ofertën tonë nga momenti i dorëzimit të saj nga ana jonë para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave deri në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

Deklarojmë se, pavarësisht nga vlefshmëria e ofertave dhe sukcesi ose dështimi i tenderit, shpenzimet për përgatitjen e ofertave dhe për përfshirjen tonë në tender, do të përballohen nga ana jonë.

Ditën e _____, datë

Emër, mbiemër

Firma dhe vula

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË

NR. _____ REP.

NR. _____ KOL.

Projekt

KONTRATA PËR SHITBLERJEN E AKSIONEVE

Sot, më datë _____, ditën e _____, përpara meje, noterit _____, me seli në Tiranë, me adresë në rrugën _____, u paraqitën personalisht,

PALËT:

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, me adresë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, e përfaqësuar nga z. Endrit **DUÇKA**, drejtor (prej këtu e më poshtë referuar si “Shitësi”),

dhe

“INSIG” sh.a., është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të shtetit shqiptar, me seli qendrore në Tiranë, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. _____, datë _____, kjo shoqëri do të nënshkruajë këtë Kontratë dhe do të përfaqësohet nga z. _____ (prej këtu e më poshtë referuar si “Blerësi”).

Palët ranë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e Kontratës së shitblerjes së aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a. Tiranë.

MEQENËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKË:

a) “INSIG” sh.a. Tiranë (më poshtë referuar si “Shoqëria”), është një shoqëri aksionare _____ e krijuar sipas vendimit të Gjykatës së



Rrethit Tiranë nr. ____ akt, datë _____, me seli në Tiranë, me adresë rruga “_____”, nr. _____. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. _____, datë _____, kapitali aktual aksionar i regjistruar është _____ lekë me _____ aksione me vlerë nominale të një aksioni, _____ lekë.

b) Më _____, Shitësi organizoi tenderin për shitjen e 100 për qind të aksioneve të “INSIG” sh.a. Tiranë me vlerë nominale _____ që përfaqësojnë _____ aksione me vlerë nominale të një aksioni _____ lekë.

c) Blerësi u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ “_____”

d) Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ “_____”

e) Kjo Kontratë vendos termat dhe kushtet, sipas të cilëve Shitësi do të shesë dhe Blerësi do të blejë aksionet, subjekt i termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Përveç termave të tjerë të përkufizuar diku tjetër në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtëm:

a) “Kontratë” do të thotë kjo Kontratë për blerjen e aksioneve, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme dhe anekset e nënshkruara dhe shkëmbyera ndërmjet Blerësit dhe Shitësit.

b) “Mbyllje” do të thotë blerja dhe shitja e aksioneve, pagesa e plotë e çmimit të pagueshëm në datën e mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumenteve dhe kryerja, përmbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për t’u nënshkruar dhe për t’u shkëmbyer, për t’u kryer dhe për t’u përmbushur në mbyllje në përmbushje me këtë Kontratë.

c) “Data e mbylljes” do të thotë data në të cilën aktualisht mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj kontrate, ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

d) “Barrë” do të thotë çdo shkak i ligjshëm preferimi, si: hipotekë, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të pare, e drejta e parablerjes, barrë ose interesa sigurimi të çdolloji, ose çdolloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, por pa u kufizuar, transferimin e një titulli ose marrëveshje mbajtjeje) që kanë efekt të ngjashëm.

e) “Humbje” ose “Humbjet” do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime të cilat janë pasojë direkte e shkeljes së deklaratave dhe garancive të specifikuara në nenin 5.

f) “Pala” ose “Palët” do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç e kërkon konteksti.

g) “Çmimi i blerjes” do të thotë çmimi në lekë, që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e aksioneve, siç tregohet në nenin 3.

h) “Aksione të shitura” do të thotë numri prej _____ aksionesh të zakonshme plotësisht të paguara, me një vlerë nominale prej _____ lekësh secili, të barabarta me _____ të aksioneve të emetuara të kapitalit të shoqërisë.

Titujt në këtë Kontratë nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 2

Objekti i Kontratës

Në bazë dhe subjekt të kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e mbylljes Shitësi do t’i shesë Blerësit, dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi _____ aksione dhe çdo të drejtë që u përket aksioneve, të lira nga çdo barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3.

Mbyllja e transaksionit të parashikuar në këtë Kontratë që do të kryhet në datën e mbylljes do të zhvillohet në zyrat e Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, më datë _____, ora _____.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe metoda e pagesës

Çmimi i blerjes së aksioneve është _____ lekë.



Blerësi (“INSIG” sh.a.) ka kryer likuidimin e vlerës për blerjen e 100 për qind të paketës së aksioneve të “INSIG” sh.a., Tiranë, në vlerën _____ lekë. Kalimi i shumës në nr. e llogarisë _____ pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike është kryer më datë _____.

Neni 4 Mbyllja

Përveç ndonjë veprimi tjetër për t’u ndërmarrë dhe të ndonjë instrumenti tjetër për t’u nënshkruar dhe/ose dorëzuar në përputhje me këtë Kontratë, në mbyllje:

a) Shitësi do të:

i) dorëzojë vendimin e Këshillit të Ministrave për pjesëmarrësin fitues;

ii) nënshkruajë dhe dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e instrumenteve të tjera që mund të jenë të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për t’i kaluar Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm për aksionet dhe në çdo mënyrë të arrijë qëllimin e kësaj kontrate.

b) Blerësi do të:

i) paguajë të plotë çmimin e blerjes në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate në shumën e caktuar në nenin 3 të kësaj kontrate;

ii) dorëzojë vendimet e organeve drejtuese të Blerësit, që autorizojnë nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate. Aneksi “B” bashkëngjitur kësaj kontrate.

Në përfundim, Blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet në datën e mbylljes dhe do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to duke filluar nga data e mbylljes.

Neni 5 Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Shitësi i deklaron dhe i garanton Blerësit sa më poshtë:

a) Shitësi është një institucion i organizuar sipas rregullave, i bazuar në ligjet e Shqipërisë dhe ka autoritet dhe pushtet të plotë për të drejtuar veprimtarinë e tij. Shitësi ka pushtet dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontratë dhe të zbatojë transaksionet e miratuara në këtë Kontratë. Shitësi ka ndërmarrë gjithë veprimet që

duhen ndërmarrë, për të autorizuar zbatimin dhe dërgesën e kësaj kontrate, si dhe transaksionet e miratuara këtu. Kjo Kontratë është një Kontratë ligjore, e vlefshme dhe detyruese për Shitësin, e detyrueshme në përputhje me termat e saj.

b) Shoqëria “INSIG” sh.a. është një shoqëri e organizuar sipas rregullave, e bazuar në ligjet e Shqipërisë dhe ka autoritet dhe pushtet të plotë për të drejtuar veprimtarinë e saj siç është drejtuar deri tani dhe të zotërojë pronat dhe aktivet që ka tashmë në zotërim dhe është kualifikuar apo licencuar sipas rregullave të kryejë veprimtari në çdo juridiksion, në të cilin zotërimi i pronës apo drejtimi i veprimtarisë kërkon të tillë kualifikim apo licencë. Kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të themelimit të shoqërisë, me gjithë ndryshimet deri në datën e sotme, i janë vënë në dispozicion Blerësit për shqyrtim.

Përveç atyre që janë miratuar në nenin 4 të kësaj kontrate, nuk do të ketë më përmirësime apo ndryshime të dokumenteve të themelimit para datës së mbylljes.

c) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është _____ lekë dhe përbëhet nga _____ aksione, me vlerë nominale _____ lekë për çdo aksion të zakonshëm. Gjithë aksionet e kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë emtuar të vlefshme, plotësisht të paguara. Në datën e mbylljes, Blerësi do të bëhet pronari i 100 për qind të aksioneve me vlerë nominale _____ lekë për çdo aksion, të lira dhe të pastra nga gjithë pretendimet dhe barrën e çdolloji. Asnjë person nuk ka pretenduar të jetë zotëruar i ndonjë barre në kapitalin aksionar të shoqërisë.

d) Zbatimi, dorëzimi dhe ecuria nga Shitësi i kësaj kontrate dhe përmbushja e transaksioneve të miratuara këtu:

i) nuk do të dhunojnë asnjë klauzolë të ndonjë ligji, rregulloreje, urdhri apo gjykimi të zbatueshme për Shitësin ose shoqërinë;

ii) nuk do të kërkojë asnjë leje ose arkivim apo njoftim të asnjë autoriteti qeveritar apo rregullator sipas çdo klauzole të ligjit të aplikueshëm apo rregulloreje me përjashtim të atyre lejeve tashmë të siguruara;

iii) nuk do të dhunojë apo të përbëjë një shkelje të asnjë klauzole të dokumenteve organizative dhe/ ose të themelimit të Shitësit apo të shoqërisë;



iv) nuk do të kërkojë asnjë leje dhe nuk do të rezultojë në shkeljen e asnjë kontrate në të cilën Shitësi apo shoqëria janë palë ose me anë të të cilave Shitësi apo shoqëria apo çdo aktiv respektiv i rëndësishëm, janë të lidhura, me përjashtim të atyre lejeve dhe dokumenteve, të cilat tashmë janë siguruar.

v) Në rast se, përveç përcaktimeve të bëra në paragrafin e mësipërm dhe për funksionimin normal të aktivitetit të shoqërisë brenda 15 ditësh pas nënshkrimit të Kontratës, Shitësi garanton regjistrimin.

e) Shoqëria ka siguruar licencat, lejet apo miratime të tjera të nevojshme për ta lejuar atë të vazhdojë të drejtobjë veprimtarinë e saj si deri më tani dhe secila nga këto është e vlefshme dhe në fuqi.

Neni 6

Deklarimet dhe garancitë e Blerësit

Blerësi këtu deklaron dhe garanton Shitësin, si më poshtë:

a) Blerësi është një shoqëri e organizuar sipas rregullave të shtetit shqiptar dhe ekziston në mënyrë të ligjshme sipas ligjeve të juridiksionit të saj për shoqëritë.

b) Blerësi ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontratë dhe të zbatojë transaksionet e miratuara nga kjo Kontratë. Asambleja e Ortakëve e Blerësit ka ndërmarrë gjithë veprimet e kërkuara prej tij për të autorizuar nënshkrimin, zbatimin dhe dërgimin e kësaj kontrate dhe për të përmbushur transaksionet e miratuara këtu, dhe nuk është i nevojshëm asnjë veprim tjetër korporate nga ana e Blerësit për të përmbushur transaksionet e miratuara këtu. Kjo Kontratë është një kontratë ligjore, e vlefshme dhe detyruese për Blerësin, e zbatueshme në përputhje me termat e saj.

c) Nuk kërkohet asnjë leje, miratim, autorizim apo deklaram, i arkivuar ose i regjistruar, nga asnjë autoritet qeveritar apo rregullator, nga dhe në emër të Blerësit apo të ndonjë prej filialeve të tij, në lidhje me zbatimin, dërgimin dhe ecurinë e kësaj kontrate nga Blerësi apo përmbushjen nga Blerësi të transaksioneve të miratuara këtu.

d) Blerësi ka siguruar licenca, leje apo miratime të tjera të nevojshme për ta lejuar atë për të vazhduar veprimtarinë dhe secila nga këto është e vlefshme dhe në fuqi.

e) Zbatimi, dërgimi dhe ecuria e kësaj kontrate

nga ana e Blerësit dhe përmbushja e transaksioneve të miratuara këtu:

i) nuk do të dhunojnë asnjë klauzolë të çdo ligji, rregulloreje, urdhri apo gjykimi të zbatueshëm për Blerësin;

ii) nuk do të kërkojë asnjë leje ose arkivim ose njoftim të çdo autoriteti qeveritar apo rregullator, sipas çdo klauzole të ligjit në fuqi apo rregulloreje me përjashtim të çdo lejeje tashmë të arritur;

iii) nuk do të cenojë apo nuk do të përbëjë një shkelje të asnjë klauzole të dokumenteve të themelimit të Blerësit;

iv) nuk do të shkelë asnjë kontratë në të cilën Blerësi është palë, me përjashtim të atyre lejeve dhe dokumenteve të dorëheqjes të cilat tashmë janë siguruar.

Neni 7

Kushtet e mbylljes

7.1 KUSHTET DHE DETYRIMET E SHITËSIT

a) Blerësi do t'i ketë përmbushur gjithë detyrimet e tij të vendosura në këtë Kontratë para/në datën e mbylljes.

7.2 KUSHTET DHE DETYRIMET E BLERËSIT

a) Shitësi do t'i përmbushë gjithë detyrimet e tij të vendosura në këtë Kontratë para/në datën e mbylljes.

Neni 8

Dëmshpërblimi nga Shitësi

8.1 DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi bie dakord të ruajë Blerësin ose shoqërinë, sikurse mund të jetë rasti, të padëmtuar dhe të dëmshpërblyer, nga çdo humbje që rrjedh nga ose e lidhur me faktet ose rrethanat e ndodhura përpara datës së mbylljes.

Blerësi nuk do të dëmshpërblehet në rast se humbja apo dëmi i pretenduar prej tij përpara datës së mbylljes, nuk do të jetë vendosur nga Gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë.

8.2 PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET

Në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklaratave dhe garancive, njoftimi i të cilave i është dhënë Shitësit pas 12 muajve nga data e kësaj kontrate.

Blerësi nuk mund të ngrejë ndonjë pretendim kundër Shitësit për dëmshpërblim në masën që



një pretendim i tillë mund të ngrihet ose rritet si rezultat i ndonjë ndryshimi në legjislacionin e zbatueshëm ose në interpretimin e ndonjë ligji ekzistues që nga data e mbylljes.

Neni 9

Ligji që do të zbatohet; zgjidhja e konflikteve

9.1 AMENDIMET DHE MODIFIKIMET

Kjo Kontratë do të sundohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

9.2 ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Çdo polemikë apo pretendim që del në pah nga kjo Kontratë ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet dhe do të rregullohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10

Të ndryshme

10.1 AMENDIMET DHE MODIFIKIMET

Subjekt i ligjit aplikativ, kjo Kontratë mund të amendohet, ndryshohet dhe shtohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të palëve.

10.2 NEGLIZHIMI I PËRMBUSHJES

Secila nga kërkesat apo kushtet e kësaj Kontrate, e cila mund të mos përmbushet ligjërisht nga palët për çdo lloj neglizhence, një mospërmbushje e tillë mund të pretendohet në formë të shkruar në çdo kohë nga Pala e cila është e autorizuar për të marrë përfitimet që rrjedhin prej kësaj kontrate. Çdo pretendim i tillë nga çdo palë do të jetë me shkrim dhe i nënshkruar në emër të saj.

10.3 NJOFTIMET

Gjithë njoftimet apo komunikimet e tjera që burojnë prej këtu, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të konsiderohen të dhëna efektive:

i) përmes dërgimit në qoftë se dorëzohen personalisht;

ii) përmes dërgimit në qoftë se dorëzohen nga korrieri; ose iii) përmes njoftimit të marrjes në qoftë se jepen me anë të telefaksit që konfirmohet me anë të postës së regjistruar; kthe marrjen e kërkuar, në çdo rast në qoftë se është e adresuar si më poshtë:

Në qoftë se i adresohet Shitësit:

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike,
Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Telefon: +355 4 2229733

Fax: +355 4 222 8405

Në vëmendje të z. Endrit DUÇKA, Drejtor

Në qoftë se i adresohet Blerësit:

Emri “INSIG” sh.a.

Adresa: Rruga e Kavajës; nr. 116, Tiranë,
Shqipëri

Telefon: 042234170

10.4 TRANSFERIMI

Kjo Kontratë dhe gjithë dispozitat që burojnë prej saj duhet t'i nënshtrohen dhe të hyjnë në veprim për përfitimet e palëve që bëjnë pjesë në këtë Kontratë dhe pasardhësve të tyre respektivë dhe transferimeve të lejuara. As kjo Kontratë as edhe ndonjë nga të drejtat, interesat apo detyrimet që rrjedhin prej këtej nuk do të transferohen nga asnjëra palë pa marrë më parë miratimin e shkruar të Palës tjetër, me përjashtim të rastit kur Blerësi ka të drejtë t'u transferojë të drejtat, interesat dhe detyrimet e tij sipas kësaj kontrate çdo shoqërie të përcaktuar nga Blerësi, duke siguruar, që Blerësi do të mbetet plotësisht i detyruar ndaj ecurisë së detyrimeve të Blerësit sipas kësaj kontrate ndaj çdo shoqërie tjetër.

10.5 PUBLIKIMI

Asnjë nga Blerësit, drejtorët, nëpunësit apo të punësuarit e tij apo Shitësi nuk do të bëjë apo të nxjerrë apo të shkaktojë bërjen apo nxjerrjen e ndonjë publikimi, lajmërimi apo deklarate të shkruar lidhur me këtë Kontratë apo transaksionet e miratuara këtu pa marrë më parë miratimin e palëve të tjera. Kjo klauzolë nuk do të përdoret për çdo publikim, njoftim apo deklarim të shkruar që kërkohet nga ligji.

10.6 SHPENZIMET

Me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe, gjithë shpenzimet dhe kostot legale dhe kostot e tjera të kryera në lidhje me këtë Kontratë dhe transaksionet e miratuara këtu do të paguhën nga pala që shkakton të tilla kosto dhe shpenzime. Blerësi është përgjegjës për të mbuluar të gjitha shpenzimet ligjore dhe të noterisë në lidhje me regjistrimin e kësaj shitjeje.

10.7 EKZEMPLARËT

Kjo Kontratë mund të ekzekutohet në mënyrë të njëkohshme në dy apo më shumë ekzemplarë, secili prej të cilëve do të konsiderohet si origjinal, por të tërë së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin dokument.

10.8 KONTRATA SI E TËRË

Kjo Kontratë, së bashku me të gjitha anekset



shoqëruese, përbëjnë Kontratën e tërë dhe mirëkuptimin e palëve në lidhje me objektin e përmbajtur këtu, dhe zëvendëson gjithë marrëveshjet e mëparshme, premtimet, kontratat, rregullimet, komunikimet, deklaratimet apo garancitë, gojore apo të shkruara, nga çdo nëpunës, i punësuar apo përfaqësues i çdo pale. Me përjashtim të atyre që janë shprehimisht të shprehur më lart, gjithë kushtet, garancitë, deklaratimet dhe kuptimet në lidhje me subjektin e kësaj kontrate janë përjashtuar dhe Blerësi pohon se nuk ka hyrë në këtë Kontratë prej asnjë premtimi të bërë, deklarimi apo garancie tjetër përveç atyre të përmbajtura në dispozitat e shkruara të kësaj kontrate, qofshin këto të shprehura apo të nënkuptuara, gojore, në formë të shkruar apo të përcjella dhe as sekondare apo ndryshe, ku çdolloj premtimi, deklarimi apo garancie këtu përjashtohet dhe shuhet në përputhje me, dhe e gjithë ujdia e palëve do të jetë ekskluzivisht siç është shprehur në dispozitat e shkruara të kësaj kontrate.

10.9 PALËT E TRETA

Asnjë nga çfarë është shkruar këtu, e shprehur apo e nënkuptuar, nuk ka pasur për qëllim dhe nuk do të interpretohet me qëllim që t'i akordojnë apo t'i japin kujtdo personi apo korporate, përveç palëve dhe pasardhësve apo të ngarkuarit të tyre, asnjë të drejtë apo rregullim sipas ose për shkak të kësaj Kontrate.

10.10 GARANCI TË TJERA

Si përpara dhe pas datës së mbylljes, palët do të bashkëpunojnë në mirëbesim me njëra-tjetrën dhe duhet të ndërmarrin gjithë veprimet e duhura dhe të zbatojnë çdo dokument, instrument apo tjetërsime të çdo tipi të cilat mund të jenë të nevojshme apo të këshillueshme për të zbatuar secilin nga transaksionet e miratuara këtu.

10.11 PAVLEFSHMËRIA

Në rast se një apo më shumë nga dispozitat që përmban në këtë Kontratë, apo në çdo instrument tjetër të cilit i referohemi këtu, do të konsiderohet, për çdo arsye, i pavlefshëm, ilegal ose i padetyrueshëm për zbatim në çdo aspekt, atëherë deri në kufirin maksimal të lejuar nga ligji, kjo pavlefshmëri, ilegalitet apo mungesë detyrimi nuk do të ndikojë ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Kontrate apo të ndonjë instrumenti tjetër dhe Palët do të orvaten të zgjidhin me mirëkuptim ndrejten e kësaj dispozite në një mënyrë që ajo të mos jetë e pavlefshme, ilegale apo jodetyruese.

Neni 11

Kuadri ligjor

Baza ligjore mbi të cilën lidhet kjo Kontratë është:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Akti normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008.
- Ligji nr. 8334 datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8831, datë 22.11.2001, “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 21.8.1998.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.6.2015, “Për caktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a.”.
- _____
- _____
- _____
- Aktet e themelimit të shoqërisë.

Neni 12

Gjuha e Kontratës

Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe dhe përbëhet nga _____ (_____) faqe dhe është hartuar në 5 (pesë) kopje origjinal, në gjuhën shqipe.

Kontrata iu lexua palëve prej meje, noterit me zë të qartë dhe të kuptueshëm dhe palët, pas deklaratimit se e gjejnë këtë Kontratë me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë Kontratën në praninë time dhe unë noteri vërtetoj këtë Kontratë dhe nënshkrimet e palëve sipas ligjit.

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nga Z. Endrit **DUÇKA** BLERËSI
Titulli: Drejtor



Nga “INSIG” sh.a., Tiranë

Emri:

Titulli:

NOTERE

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016